

# BULETIN

No 1

## UJI I KOSOVËS

#ujëpërkosovën

Ministri Murati nënshkroi marrëveshjen e Programit "Menaxhimi i Integruar i Resurseve Ujore në Kosovë"- Faza 1, me Ambasadorin e Zvicrës në Republikën e Kosovës, Thomas Kolly





**DIMITRIJA SEKOVSKI, PHD**  
UDHËHEQËS I EKIPIT / PROGRAMI I MENAXHIMIT  
TË INTEGRUAR TË RESURSEVE UJORE NË KOSOVË  
(IWRM-K)

# NË MISION PËR TË OFRUAR UJË TË SIGURT PËR ÇDO FËMIJË, GRUA DHE BURRË NË KOSOVË.

## EDITORIAL

Ky është buletini i parë i dedikuar ujit në Kosovë ndonjëherë. Programi i Menaxhimit të Integruar të Resurseve Ujore në Kosovë (IWRM-K), i mbështetur nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Qeveria e Kosovës, ofron një platformë për diskutime rreth menaxhimit të resurseve ujore në Kosovë.

Ky buletin do të ofrojë lajmet më të fundit për ujin, do të trajtojë tema të rëndësishme dhe zhvillimet përkatëse dhe do të ofrojë zgjidhje për sfidat e vazhdueshme dhe të ardhshme.

Misioni i IWRM-K është të angazhojë (njerëz, burime), të ofrojë prototipe (zgjidhje), katalizojë (transformojë) dhe të shkallëzojë rezultatet drejt ndryshimit të prekshëm pozitiv afatgjatë në menaxhimin e resurseve ujore në Kosovë. Qëllimi përfundimtar i programit është të ofrojë “ujë të sigurt për çdo fëmijë, grua dhe burrë në Kosovë.”

Buletini i bënë bashkë palët kryesorë të interesit për ujin – siç janë institucionet, shoqëria civile, komunitetet e prekura – si dhe mbështetësit ndërkombëtarë, të cilët ndajnë të njëjtin entuziazëm për krijimin e një të ardhmeje më të ndritshme për Kosovën përmes mbrojtjes së përmirësuar të mjedisit dhe menaxhimit më të mirë të resurseve ujore. Buletini do t'i ndihmojë të gjitha këto palë të interesit të përafrojnë më mirë vizionet e tyre për të ardhmen dhe të koordinojnë veprimet që maksimizojnë dhe ndikojnë në ndryshime kuptimplota.

Duke u abonuar për këtë buletin, lexuesit do të jenë të informuar mbi rezultatet dhe progresin e Programit IWRM-K. Ekipi i Programit mirëpret komentet se si të përmirësohet ky publikim.

# NJOFTIMET KRYESORE

ZVICRA  
MBËSHËTET KOSOVËN PËR TË  
PËRMIRËSUAR MENAXHIMIN E  
RESURSEVE UJORE



Përgjatë shekujve, Zvicra ka krijuar një përvojë të madhe në sektorin e ujit. Në 15 vitet e fundit, Zvicra e ka ndihmuar Kosovën për të siguruar ujë për 600 mijë njerëz. Tani, Zvicra ndihmon Kosovën në përmirësimin e menaxhimit të resurseve ujore. Ky kontribut i rëndësishëm mbron resurset natyrore dhe mbështet një ekonomi më të qëndrueshme. Vendi im është i lumtur ta ndajë këtë përvojë me Kosovën.

Uji i ëmbël është një resurs i kufizuar. Ndryshimet klimatike, rritja e popullsisë dhe modelet e reja të konsumit po ushtrojnë presion mbi furnizimin me ujë në botë. Nuk ka alternativë për ujin. Ky Program po hap rrugën drejt një të ardhmeje më të qëndrueshme të ujit, për të gjithë, në Kosovë dhe do t'i mbajë të lidhur institucionet, ekspertët dhe qytetarët e të dy vendeve.

Thomas Kolly  
Ambasador i Zvicrës  
në Republikën e Kosovës

MENAXHIM  
MË MIRË I UJIT PËR TË  
ARDHMEN E KOSOVËS



Ky Program do të na ofrojë mbështetjen e shumëpritur në rrugën tonë drejt përmirësimit rrënjësor të menaxhimit të ujërave në Kosovë. Pritjet tona nga partneriteti që kemi ndërtuar me Zvicrën janë shumë të larta, po aq të larta sa edhe vendosmëria jonë për të vazhduar me agjendën ambicioze të reformave të cilën e kanë vendosur institucionet dhe populli i Kosovës. Duke ndërtuar kapacitete për të trajtuar sfida të shumta, ky Program do të ndihmojë në sigurimin e ujit të mjaftueshëm për njerëzit, ekonominë dhe ekosistemet tona.

Ne po hyjmë në një proces ambicioz të transformimit dhe kombinimi i ekspertizës zvicerane dhe reformës me bazë në BE do ta ndihmojë më tej vendin të ndërmarrë hapa të mëdhenj drejt përmbushjes së agjendës së tij të qëndrueshmërisë. Qindra mijëra bujq do të rrisin bagëtinë dhe do të arrijnë një jetesë të denjë në mënyrë më të lehtë. Një model i qëndrueshëm modern i qeverisjes së ujit do të sigurojë një të ardhme me ujë për të gjithë njerëzit në Kosovë.

Liburn Aliu  
Ministrër i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor  
dhe Infrastrukturës

# IWRM – UJË PËR KOSOVËN DHE ZHVILLIMIN E QËNDRUESHËM EKONOMIK

Uji ka një rëndësi të madhe ekonomike për Kosovën, veçanërisht për industrinë dhe bujqësinë e saj, mirëpo shpërndarja jo e barabartë e resurseve ujore ndikon në trendet e rritjes ekonomike kombëtare. Mbi 62% e popullsisë së vendit jeton në zonat rurale, ku bujqësia është një nga sektorët kryesorë ekonomikë. Për shkak të mungesës së menaxhimit efikas të burimeve ujore, bujqit në Kosovë përveç problemeve të tjera, aktualisht përballen edhe me sfida të ndryshme lidhur me ndotjen e tokës, ujitjen, kullimin dhe degradimin e tokës pjellore. Me rritjen e ndryshimeve klimatike, këto sfida do të përkeqësohen edhe më tej në të ardhmen.



Prandaj, ekziston nevoja për një qasje të integruar që lidh menaxhimin e resurseve ujore dhe zhvillimin e qëndrueshëm, duke arritur kështu përdorimin ekonomikisht efikas të ujit dhe barazinë sociale, si dhe qëndrueshmërinë mjedisore dhe ekologjike.

# RRETH PROGRAMIT IWRM-K

Programi i Menaxhimit të Integruar të Resurseve Ujore në Kosovë (IWRM-K) është një iniciativë transformuese 12-vjeçare që trajton shkaqet rrënjësore të sfidave të Kosovës lidhur me ujin. Në vazhdimësi të fazës së parë (2020-2024), Programi do të krijojë një kornizë të planifikimit, të njohurive dhe kapaciteteve institucionale të nevojshme për të transformuar menaxhimin e resurseve ujore të vendit.

**GJATË KATËR VITEVE TË ARDHSHE, KY PROGRAM DO NDIHMOJË TË ZHVILLOHET NJË VIZION I PËRBASHKËT SE KU NJERËZIT DËSHIROJNË TË JETË KOSOVA PAS 12 VITESH NGA TANI, PËRMES:**



## PLANEVE DHE MASAVE:

Për të kuptuar më mirë streset e ujit, shkaqet e tyre rrënjësore dhe përgjigjet përkatëse të menaxhimit - të gjitha këto do të përfshihen në planet e para të menaxhimit të pellgjeve lumore të vendit.

Programi po harton të gjitha veprimet e suksesshme të ujit të ndërmarra deri më sot dhe do të përshkallëzojë masat që trajtuan me sukses mangësitë sistemike.

Po hartohen skemat e granteve për të mbështetur zgjidhje praktike të cilat do të reduktojnë ndotjen dhe përdorimin e ujit në bujqësi dhe industri.

## LEGJISLACIONIT, INSTITUCIONEVE DHE NJOHURIVE:

Do të zhvillohet dhe prezantohet legjislacioni modern i ujit.

Zhvillimi i kapaciteteve institucionale dhe organizative për menaxhimin e resurseve ujore po mbështetet ndërmjet institucioneve partnere përmes një sërë trajnimesh dhe shkëmbimesh nga palët e përfshira.

Në universitetet kombëtare po futen lëndet më të mira shkencore të ujit, duke krijuar gjithashtu mundësi trajnimi në vendin e punës për profesionistë të rinj, ekspertë dhe studiues.

Monitorimi aktual i ujit dhe Sistemi i Informacionit për Ujërat (SIU) janë duke u përmirësuar.

## PJESËMARRJA E PALËVE TË INTERESIT, ORGANIZATAVE TË SHOQËRISË CIVILE DHE RITJA E VETËDIJËSIMIT:

Mekanizmat e rinj të pjesëmarrjes së palëve të interesit do të sigurojnë demokratizimin e menaxhimit të resurseve ujore.

Palët e interesit dhe OShC-të janë duke u fuqizuar që të bashkëpunojnë me Qeverinë në menaxhimin e resurseve ujore përmes trajnimeve dhe granteve të synuara.

Një sërë aktiviteteve komunikimi dhe ndërgjegjësimi në nivel kombëtar dhe lokal do të nxisin veprimin dhe do ta pozicionojnë menaxhimin e resurseve ujore si një prioritet kryesor në agjendën politike të vendit.

**E gjithë kjo do të çojë në zhvillimin e një modeli të qëndrueshëm modern të qeverisjes së ujit – duke siguruar ujë në të ardhmen për çdo fëmijë, grua dhe burrë në Kosovë.**

# GRUPET PUNUESE (GP)

Programi ka krijuar Grupet Punuese që do të ndihmojnë në dinamikën dhe bashkëpunimin ndërinstitucional gjatë hartimit të Planeve të Menaxhimit të Pellgjeve Lumore (PMPL). Rezultatet e Grupeve Punuese (GP) do të jenë të dobishme për institucionet kyçe, duke filluar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore (ARPL). Grupet Punuese do të kontribuojnë gjithashtu në pjesëmarrjen dhe partneritetet efektive të palëve të interesit që ndihmojnë në zhvillimin dhe zbatimin e koordinuar të PMPL-ve.

## PËRFSHIRJA E PALËVE TË INTERSIT & VETËDIJËSIMI

Është më rëndësi që PMPL-të të plotësohen edhe përmes identifikimit dhe përfshirjes së palëve të interesit, duke përfshirë krijimin e mekanizmave inovativë të pjesëmarrjes.

Palët e interesit jo-institucionale, siç janë OSHC/OJQ-të, bujqit, akademika, bizneset dhe grupet e cënueshme, do të zënë një vend të veçantë.

Programi është afër kompletimit të Modelit për Mekanizmat e Pjesëmarrjes së Palëve të Interesit relevante për Menaxhimin e Integruar të Resurseve Ujore në Kosovë. Programi gjithashtu po mbështet aktivitetet e komunikimit dhe vetëdijësimit për të arritur tek palët kryesore dhe popullata e përgjithshme e Kosovës.

## EDUKIMI MBI UJIN

Programi po zhvillon një program të trajnimit prezantues, por gjithëpërfshirës, mbi Programin IWRM-K. Qëllimi kryesor i këtij aktiviteti është mbështetja për zhvillimin e njohurive dhe aftësive të zyrtarëve shtetëror (të ujit), profesionistëve të rinj (të ujit), akademikëve dhe studiuesve, OSHC/OJQ-ve dhe palëve tjera të interesit. Programi i trajnimit do të përcaktohet nga temat, objektivat e mësimin, materiali mësimor dhe metodat e trajnimit.

Programi, gjithashtu, do të mbështesë zhvillimin e një Programi Master ndërdisiplinor në IWRM. Programi Master synon të sjellë njohuri ndërdisiplinore tek një audiencë e larmishme e synuar me formime të ndryshme arsimore dhe me përvojë profesionale, duke përfshirë inxhinierinë, ekonominë, ekologjinë, shkencën mjedisore dhe shkencat sociale.



# PLANET E MENAXHIMIT TË PELLGJEVE LUMORE DHE VLERËSIMI I BILANCIT UJOR

Planet e Menaxhimit të Pellgjeve Lumore (PMPL) do të projektojnë dhe zbatojnë në mënyrë efektive zgjidhjet e menaxhimit të qëndrueshëm mbi përdorimin e drejtë të resurseve ujore dhe balancimin e interesave kontradiktore të menaxhimit të ujit. Programi IWRM-K do të mbulojë tre pellgje lumore (Ibër, Morava e Binçës dhe Lepenci) dhe do të përmirësojë rrënjësisht kapacitetet e Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), dhe Autoritetit Rajonal të Pellgjeve Lumore (ARPL).

Studimi i Bilancit Ujor, i cili është në proces e sipër, do të ofrojë analiza të detajuara në nivel vendi dhe në shkallë pellgu të disponueshmërisë së resurseve ujore në hapësirë dhe kohë, analiza ekonomike të menaxhimit të resurseve ujore dhe mbështetje për zhvillimin e kapaciteteve për Institutin Hidrometeorologjik të Kosovës (IHMK).

## MBËSHTETJA E ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM BUJQËSOR

Ndotja e ujit mbetet një nga problemet më serioze për shëndetin e qytetarëve dhe mjedisin në Kosovë. Ndotja dhe degradimi i resurseve ujore përkeqëson menaxhimin e përgjithshëm të ujit. Ndotja difuze është ndër sfidat e lidhura veçanërisht me aktivitetet bujqësore. Për të ndihmuar në adresimin e kësaj çështjeje, Programi do të ndihmojë bujqit në zonat prioritare, të një ose më shumë pellgjeve lumore të synuara, të modifikojnë praktikatat e tyre bujqësore, të tilla si kontrolli më i mirë i përdorimit të agrokimikateve dhe ujit për vaditje, parandalimi i humbjes së lëndëve ushqyese nga toka në trupat ujorë dhe proceset e erozionit. Programi ka nisur tashmë një Skemë të Granteve Konkurruese (SGK) që synon bujqit në të gjithë vendin.



# GRATË DHE MENAXHIMI I UJIT NË BUJQËSI



Personat me aftësi të veçanta, të cilët janë përdorues të ujit për bujqësi, përballen me sfida të ndryshme, e të cilat mund të ndikojnë në produktivitetin, shëndetin dhe në cilësinë e jetës së tyre. Zonja Fatime Limaj bashkë me familjen e saj jeton në fshatin Banjë, Komuna e Malishevës. Edhe pse një person me aftësi të veçanta, ajo është një fermere e suksesshme e përkushtuar për rritjen e zinxhirit të vlerës së produkteve bujqësore, nga prodhimi deri në konsumin përfundimtar. Ajo është themeluese dhe kryetare e Shoqatës së Grave "Fatjona", e cila punëson pesë punëtore, përpunon perime dhe prodhon turshi. Këto produkte kanë tregje në Kosovë dhe në Gjermani. Të gjithë suksesin ia dedikon bashkëshortit, gjithashtu një person me aftësi të veçanta, i cili e ka mbështetur në çdo hap të jetës së saj. Të dy kanë në bashkëpronësi 30 ari tokë, ndërsa Znj. Limaj nga kunati i saj ka marrë disa ari tokë për shfrytëzim, për 10 vite, e që edhe këtë tokë e ka regjistruar në emrin e vet. Prandaj, ajo mund të marrë më lehtë grante dhe subvencione për të zgjeruar punën e saj.



Pranë shtëpisë, ku ajo jeton, ndodhet një serë shumë e madhe ku ajo kryesisht mirret me kultivimin e trangujve dhe domateve, ndërsa në fushë të hapur kultivon specia dhe lakra. Fatkeqësisht, ajo dhe bashkëshorti i saj nuk kanë qasje në një sistem të ujitjes, kanë vetëm një bunar. Në mungesë të shirave, ata nuk mund të ujitin të gjitha bimët e tyre në kohën e duhur. Ajo është e bindur se një plan i menaxhimit të ujit në mbarë Kosovën do të përmirësonte rendimentet e të korrave, duke përmirësuar statusin ekonomik të familjes së saj dhe atë të komunitetit në të cilin ajo jeton. Një sistem i organizuar i ujitjes me cilësi të lartë do të kishte një efekt pozitiv duke maksimizuar rendimentet e kulturave që ajo kultivon.



## MENAXHIMI I UJIT TEK BIZNESET ME AKUAKULTURË NË SHKALLË TË VOGËL (PESHKIMI)

Përgjatë lumit Lumbardhi dhe mbi grykën e Rugovës, në Malaj, z. Alban Lajqi ka në pronësi një resort biznesi të quajtur Kampi i Rugovës. Që nga viti 2000, ky kamp është një ndër bizneset e para familjare në këtë zonë. Në periudhën më të mirë sezonale, resorti pret mijëra vizitorë të cilët shijojnë bukurinë natyrore të kombinuar me ushqimin tradicional dhe mikpritjen lokale. Atje z. Lajqi ka ndërtuar një rezervuar për kultivimin e peshkut troftë për klientët e tij.

Ai ka adoptuar një sistem mjedisor miqësor, ku uji i ëmbël hyn në rezervuar nga lumi dhe qarkullon normalisht, pa pasur asnjë ndikim negativ në mjedis. Megjithatë, z. Lajqi po përballë me sfida të qëndrueshmërisë, prej monitorimit të cilësisë dhe sasisë së ujit si dhe kohës së duhur të ushqyerjes e deri tek menaxhimi i cilësisë dhe disponueshmërisë së farës së peshkut. Ashtu si z. Lajqi, edhe fermerët e tjerë të peshkut në Kosovë duhet të adresojnë sfidat e brendshme dhe të jashtme për të mbështetur produktet e tyre. Ata kanë nevojë për mbështetje në shkallë të gjerë nga qeveria e tyre, për të rritur kapacitetet e tyre dhe për të realizuar praktika të qëndrueshme të biznesit të akuakulturës në Kosovë.



## NËNSHKRUHET MARRËVESHJA PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË RESURSEVE UJORE NË KOSOVË - FAZA 1. QEVERIA ZVICERANE DO TË MBËSHTESË KOSOVËN ME RRETH 20 MILIONË FRANGA ZVICERANE



Më 3 shtator 2021, Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve Hekuran Murati, pas negociatave të suksesshme me Qeverinë e Zvicrës, përfaqësuar nga Departamenti Federal i Punëve të Jashtme nëpërmjet Agjencisë Zvicërane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, nënshkroi një marrëveshje me ambasadorin Thomas Kolly për projektin “Menaxhimi i Integruar i Resurseve Ujore në Kosovë - Faza 1.

Ky program pritet të financohet nga qeveria zvicerane me rreth 20 milionë franga zvicerane (mbi 18 milionë euro) dhe do të zhvillohet në tri faza, ku faza e parë, nga viti 2021 deri në vitin 2024, është rreth 8.5 milionë (rreth 8 milionë euro).

Ndërsa, Qeveria e Kosovës pritet të ketë bashkëfinancim rreth 6 milionë franga zvicerane (mbi 5 milionë euro) për të gjithë projektin, ndërsa për fazën 1 do të ketë një kontribut prej 1.7 milionë (mbi 1.5 milionë euro).

### PA REFORMA URGJENTE AGJENCIA OKB-SË PËR MOTIN PARLAJMËRON KRIZË UJORE

Ndryshimet klimatike pritet të rrisin rreziqet e lidhura me ujin, siç janë thatësitrat dhe vëshimet, ndërsa numri i njerëzve që jetojnë me mungesë të ujit pritet të rritet poashtu për shkak të mungesës në rritje të ujit dhe rritjes së popullsisë, paralajmëroi raporti.

“Duhet të zgjohemi për shkak të krizës së ujit që po vjen,” tha Petteri Taalas, sekretari i përgjithshëm i Organizatës Botërore Meteorologjike (OBM) të Kombeve të Bashkuara.



“Raporti i Shërbimeve Klimatike 2021: Uji”; një bashkëpunim midis OBM, organizatave ndërkombëtare, agjencive të zhvillimit dhe institucioneve shkencore, vlerëson se deri në vitin 2050 numri i njerëzve me qasje joadekuate në ujë do të arrijë në 5 miliardë kundrejt 3.6 miliardë sa ishte në vitin 2018.

# #POSTIMETNËRRJETETSOCIALE

Java e Inovacionit të Ujit 2021

Organizuar nga: Imagine H2O  
Përshejtuesi i inovacionit të ujit -  
fuqizon njerëzit të zhvillojnë dhe  
vendosin inovacion për të zgjidhur  
sfidat e ujit globalisht 3-4 nëntor  
2021.



A e marrim si të mirëqenë furnizimin me ujë?

Epo, sigurisht jo në #Prishtinë, kryeqytetin e #Kosovës, ku fondet e #BE-së kanë ndihmuar në zgjidhjen e problemit të mungesës së ujit.

#Tani ka një furnizim të besueshëm me ujë.

A e dini se #edukimi i njerëzve dhe komuniteteve është thelbësor për të siguruar #menaxhimin afatgjatë të ujit? @unescoWATER punon me #mësues/#trajgues si pjesë e veprimit të tij #WaterEducation për të rritur kapacitetet e palëve të interesit. Në #WorldTeachersDay2021 i falënderojmë për mbështetjen e tyre



Raporti i Shërbimeve Klimatike 2021: Uji vë në pah nevojën për veprime urgjente për të përmirësuar bashkëpunimin në menaxhimin e ujit, për të përfaqësuar politikat e integruara të ujit dhe klimës dhe për të rritur investimet në këtë mall të çmuar që mbështet të gjitha synimet ndërkombëtare për zhvillimin e qëndrueshëm, përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike dhe reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë.

#NdryshimetKlimatike na kërcënojnë të gjithëve dhe shpesh shfaqen përmes ujit në format e reshjeve ekstreme, përmbytjeve, thatësirave dhe shkrires së akullnajave.

Ne nuk po bëjmë sa duhet për të shmangur krizën e afërt

Ne kemi nevojë për menaxhim më të mirë të ujit, monitorim, paralajmërime të hershme dhe investime.

## Ky BULETIN

Mbështetet nga programi IWRM-K i SDC-së i bashkëfinancuar nga Qeveria e Kosovës dhe zbatuar nga Skat Consulting Ltd., St. Gallen, Zvicër dhe Agjencia Austriake e Mjedisit (EAA).

Nëse dëshironi të shihni videon tonë promovuese, klikoni [këtu](#):

 Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development  
and Cooperation SDC



Integrated Water Resources  
Management in Kosovo



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

**skat** Swiss Resource Centre and  
Consultancies for Development

ENVIRONMENT  
AGENCY AUSTRIA **umweltbundesamt**<sup>U</sup>

## Na ndiqni

Facebook: [iwrn\\_k](#) Instagram: [iwrn\\_k](#)  
linkedin: [iwrn\\_k](#) twitter: [iwrn\\_k](#)

[www.iwrn-k.com](http://www.iwrn-k.com)

## Na kontaktoni

Skat Consulting Ltd.  
Menaxhimi i Integruar i  
Burimeve Ujore në Kosovë  
Rruga Pashko Vasa 136  
Kati I. Nr.5, Pejton  
Prishtina, Kosovë  
Email: [kosovo@skat.ch](mailto:kosovo@skat.ch)